REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

Nr. 233 prot.

KUVENDI
NR 127 DATE 14.01.19

Tiranë, më 14.1.2019

Lënda: Kërkesë e motivuar me shkrim për thirrjen e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm

*Drejtuar:*

**Z. GRAMOZ RUÇI**
**KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

**Tiranë**

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 74, pikat 2 e 3, të Kushtetutës, dhe 42, pika 2, të rregullores së Kuvendit, Ju paraqes kërkesën e motivuar me shkrim për thirrjen e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm.

Motivi i paraqitjes së kësaj kërkese lidhet me shqyrtimin dhe miratimin e dekreteve të Presidentit të Republikës për lirim dhe emërim të Zëvendëskryeministrit dhe të disa ministrave, në kuadër të ristrukturimit organik të qeverisë, për zgjerimin e objektivave të qeverisë në frymën e reformimit, përmirësimit dhe transformimit të shërbimeve, zgjerimin e kapaciteteve dhe rritjen e efikasitetit të punës.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 42, të rregullores së Kuvendit, kërkoj thirrjen e mbledhjes së Kuvendit dhe mbajtjen e seancës plenare, për votimin e dekreteve të Presidentit të Republikës për lirim dhe emërim Zëvendëskryeministri dhe të disa ministrave.

I nderuar zoti Kryetar,

Thirrja e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm, krahas garantimit të respektimit të afateve kushtetuese për shqyrtimin e dekreteve të lirim/emërimit

çmoj se i shërben funksionimit normal dhe me kapacitet të plotë të kabinetit qeverisës.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**